



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR
PËR MINIERA DHE MINERALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të KPMM-së në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderan i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Blerim Kabashi (Udhëheqëse Ekipi), dhe Ariana Rexhebeqaj (anëtar ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Qeverisja	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	23
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak KPMM 2013	26


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 17/09/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion


Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)**

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

KPMM ka arritur të dorëzojë me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara të Sekorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 06/2011.

2.1 Opinioni i Auditimit

(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

KPMM duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Në raportet për borxhet e papaguara për muajt prill, maj dhe qershor nuk ishin përfshirë të gjitha faturat e papaguara. Më tutje, në fazën finale të auditimit ne vlerësuam se për muajt në vijim raportimi i obligimeve ishte në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare për raportimi.

Në kontekst të PVF-ve dhe obligimeve tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Që nga pranimi i rekomandimeve tona për vitin 2013, KPMM ka ndërmarrë masa për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Përkundër progresit në adresimin e rekomandimeve, edhe më tutje disa çështje mbeten për t'u adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të KPMM-së ka rezultuar me tetë (8) rekomandime kryesore. KPMM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tri (3) rekomandime janë adresuar plotësisht, tri (3) janë adresuar pjesërisht dhe dy (2) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht sepse KPMM nuk ka zbatuar ndonjë plan formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve të AP-it. |
| Rreziku | Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, menaxhimi i licencave, procesi i rekrutimit, procesi i prokurimit dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme kanë rezultuar në zvogëlim të efikasitetit në operacionet e institucionit, vlerë të ulët për para dhe humbje potenciale financiare për KPMM-në. |
| Rekomandimi 1 | Kryesuesi i Bordit duhet të zbatojë një proces të qartë për monitorimin e adresimit të rekomandimeve të AP-së. Rekomandimet të cilat nuk adresohen sipas afateve, të rishikohen në baza mujore nga Kryesuesi, si dhe veprime pro aktive të ndërmerren ndaj sfidave të paraqitura gjatë zbatimit. |

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga KPMM si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi siç kërkohet me procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit marrë si tërësi ishin relativisht të mira. Megjithatë, te kategoria e investimeve kapitale kërkohet një zhvillim i mëtejshëm i procesit buxhetor. Me theks të veçantë, nevojitet t'i kushtohet vëmendje analizave lidhur me kostot për projekte kapitale për të evituar suficitin në fund të vitit.

Më tutje, kontrollet mbi menaxhimin e licencave, sigurimin e garancioneve bankare, parandalimin e aktiviteteve ilegale dhe masave për inkasimin e llogarive të arkëtueshme kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Ato në raste të caktuara ishin shmangur nga legjislacioni në fuqi. Në këtë aspekt, kontrollet duhet të forcohen për të siguruar që objektivat e KPMM-së arrihen ashtu si janë planifikuar.

Kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve ishin të mira. Megjithatë, kontrolle shtesë nevojiten te menaxhimi i procesit të prokurimit dhe procedimit të pagesave. Më tutje, kontrollet menaxheriale në proceset e rekrutimit të stafit të ri dhe avancimit të stafit të KPMM-së duhet të përmirësohen më tutje. Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë së mesëm kontrolle shtesë nevojiten edhe në raportimin e obligimeve të papaguara dhe menaxhimin programit e- pasurisë.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

KPMM ka një strukturë të definuar organizative të udhëhequr nga Bordi Drejtues. Bordi përbëhet prej 5 anëtarëve. Nga fundi i muajit prill anëtarëve të bordit i ka skaduar mandati dhe nga kjo periudhë kohore bordi ka qenë jo- funksional. Me formimin e organeve të reja legjislative ka filluar procesi i përzgjedhjes së bordit të ri.

Deri sa bordi kishte qenë funksional, linjat e raportimit ishin të strukturuar mirë dhe kishin funksionuar duke e dëshmuar këtë përmes procesverbaleve nga takimet e mbajtura nga bordi dhe raporteve të shkruara.

Në mungesë të bordit, KPMM është ballafaquar me një numër të madh sfidash duke filluar nga mos shqyrtimi i aplikacioneve për licencim, vazhdimi i licencave të cilave i ka skaduar afati, e deri të një mori sfidash të tjera në aktivitetet e tyre operative.

Bordi i ri duhet të shqyrtojë kërkesat ekzistuese të llogaridhënies dhe të ndërmerr veprime të menjëhershme për ti adresuar problemet e krijuara në mungesë të bordit.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për KPMM-në shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,835,064	1,758,600	1,552,997	1,373,100	1,262,384
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,835,064	1,758,600	1,552,997	1,373,100	1,262,384

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është më i vogël për 71,064€. Kjo ka ndodhur me vendim të Qeverisë për zvogëlimin e kategorisë mallra dhe shërbime 15% dhe 15% në kategorinë e shërbimeve komunale.

Në vitin 2014, KPMM ka shfrytëzuar 88% të buxhet final ose 1,552,997€, me një përmirësim prej 6% krahasuar me vitin 2013. Ky realizim është po ashtu reflektim i shkurtimit të buxhetit në mallra dhe shërbime dhe komunal. Megjithëse, realizimi i përgjithshëm i buxhetit është në nivel të pranueshëm, në disa kategori duhet të punohet më shumë si në fazën e planifikimit ashtu edhe në realizimin e buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,835,064	1,758,600	1,552,997	1,373,100	1,262,384
Pagat dhe Mëditjet	645,801	645,801	619,387	597,866	606,181
Mallrat dhe Shërbimet	473,763	402,699	355,588	341,131	390,594
Shërbimet komunale	36,000	30,600	22,862	21,706	34,816
Subvencione dhe Transfere	20,000	20,000	0,00	0,00	0,00
Investimet Kapitale	659,500	659,500	555,160	412,398	230,793

Pavarësisht zvogëlimit, vetëm 88% e buxhetit final ishte shpenzuar. Problemet me realizimin e buxhetit kryesisht kishin rrjedhur nga disa vështirësi, duke filluar nga planifikimi jo i mirë i vlerës

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

së projekteve kapitale dhe deri te anulimi i aktiviteteve të prokurimit në mungese të ofertave të përgjegjshme.

- Buxheti për shërbimet komunale nuk ishte realizuar sipas planifikimit vetëm 75%. Duke pasur parasysh natyrën e kësaj kategorie do të duhej të bëhej një planifikim më i përafërt dhe i bazuar në shpenzimet e viteve paraprake dhe në nevojat reale në mënyrë që realizimi të jetë i përafërt me planifikimin.
- Buxheti për mallra dhe shërbime është realizuar 88%. Kjo ka ndodhur si pasojë e pamundësisë së arritjes së marrëveshjes nga KPMM me kompani për kryerjen e shërbimeve "*Transportimi i pajisjeve të konfiskuara*". Ky aktivitet ishte ri-tenderuar katër herë brenda viti për arsye se në tri shpalljet e fundit nuk kishte ofertuar asnjë ofertues. Kontrata është arritur në muajin nëntor 2014, vlera e parashikuar e projektit ishte 40,000€, përderisa shpenzimi nuk kishte ndodhur për vitin 2014.
- Buxheti për investime kapitale është realizuar po ashtu 88%. Në mos realizimin e plotë të buxhetit në këtë kategori përveç arsyeve të paraqitura në Çështjen 2, kishte ndikuar edhe mos zhvillimi i procedurave të prokurimit për dy projekte kapitale të parapara me buxhetin e 2014. Njëri projekt "*Softwer për depo dhe inventar*" në vlerën e buxhetuar 10,000€ është instaluar nga MAP, kurse projekti tjetër "*Lidhja e qendrave regjionale*" (VPN) po ashtu në vlerë 10,000€, nuk ishte dërguar kërkesa nga njësia kërkuuese për inicimin e aktivitetit.
- KPMM me ndarjet buxhetore ka pranuar gjithashtu buxhet për kategorinë subvencione dhe transfere në vlerë prej 20,000€. Zyrtarët financiarë në KPMM theksuan se nuk kishin projekte konkrete për subvencionim dhe në vazhdimësi kanë kërkuar nga Ministria e Financave për mos alokimin e kësaj ndarjeje buxhetore.

Rekomandim

Çështja 2 - Planifikim jo i mirë i buxhetit për projekte kapitale-Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) dhe tabelës 3.2 të buxhetit për projekte kapitale, për vitet 2013/14 projekti " <i>Menaxhimi i resurseve minerale</i> " ishte buxhetuar në shumën prej 200,000€ (100,000€ vitin 2013 dhe 100,000€ në 2014). Përderisa, vlera e kontraktuar e projektit ishte 126,090€ apo 37% më vogël se vlera e buxhetuar. Po ashtu, edhe projekti " <i>Ortofotot</i> " ishte buxhetuar në vlerë prej 50,000€ ndërsa vlera e kontraktuar ishte 27,400€ apo 55% më e vogël se vlera e buxhetuar. |
| Rreziku | Planifikimi jo i mirë i buxhetit rezulton në mbajtje peng të buxhetit i cili e ka pamundësuar shfrytëzimin për aktivitete tjera prioritare në KPMM apo edhe nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore. Mungesa e një analize të bazuar në trendin historik të buxhetit për projekte kapitale ka pasur për pasoj mbajtjen e tepricave buxhetore me vite. |
| Rekomandimi 2 | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen. |
-

4.3 Të hyrat

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga KPMM në vitin 2014 ishin në total 26,966,93€, të hyrat realizohen nga shfrytëzimi i rentës minerare, gjobave dhe taksave administrative. KPMM, ka një mori kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë edhe prezantimin e tyre në PVF. Megjithatë, ekziston një nevojë për ti forcuare kontrollet për ta mbështetur pajtueshmërinë e menaxhimit të licencave dhe parandalimin e operimeve ilegale.

Gjatë auditimit tonë, sa i përket menaxhimit të licencave ne kemi identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 3 - Mos raportimi i rregullt në periudha tremujore dhe vjetore nga bartësit e licencave- Prioritet i lart

E gjetura Sipas Ligjit Nr. 03/L-163 nenit 34, dhe ligjit Nr 04/L-158 për plotësim dhe ndryshim të ligjit bazë, bartësit e licencave për shfrytëzim do të dorëzojnë raporte tremujore dhe vjetore me shkrim në KPMM. Përmes këtyre raporteve informohet KPMM sa i përket vëllimit apo sasisë së mineraleve të prodhuara, si dhe shumën e rentës minerare të cilën duhet të ja paguaj bartësi i licencës KPMM-së.

Disa nga bartësit e licencave për shfrytëzim nuk kishin raportuar në departamentet përkatëse në KPMM në lidhje me sasinë apo vëllimin e mineraleve të prodhuara, si dhe vlerën në para të rentës minerare të cilën e kanë për obligim që t'ja paguajnë KPMM-së për secilin tremujorësh.

Rreziku Mos raportimi i rregullt nga ana e bartëseve apo shfrytëzuesve të licencës për pasojë mund të ketë mungesën e informatave të plota në lidhje me vëllimin e mineraleve të prodhuara si dhe vlerën e obligimeve që e ka secili bartës i licencës ndaj KPMM-së.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për ta rritur shkallën e përgjegjësis brenda departamenteve përkatëse në mënyre që të rezultoj me ngritje të efikasitetit për raportim në pajtueshmëri me kërkesat ligjore nga bartësit e licencave.

Çështja 4 - Mos revokim i licencave apo lejeve në mungesë të garancioneve bankare dhe polisave të sigurimit ndaj palëve të treta-Prioritet i lart

E gjetura Bordi i KPPM-së, me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 me datën 01.04.2011 ka aprovuar vendimet ku obligohen të gjitha kompanit e licencuara brenda një periudhe gjashtë mujore të dorëzojnë garancionet bankare dhe sigurimet ndaj palëve të treta në KPMM. Garancionet bankare dhe polisat e sigurimit garantojnë se bartësi i licencës pas skadimit të afatit të licencës kanë fonde të mjaftueshme për realizimin e projektit dhe planin për mbylljen e minierës.

Në 45 raste bartësit e licencave nuk kanë dorëzuar në KPMM garancionet bankare për përmbushjen e detyrimeve në formën e përcaktuar nga KPMM si dhe në 25 raste bartësit e licencave nuk kanë dorëzuar polisën e sigurimit ndaj palëve të treta. Bordi i KPMM-së nuk kishte marr asnjë vendim për revokimin e licencave

Periudha e garancionit e ofruar nga bartësit e licencave jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Afati i Licencës për shfrytëzim me nr 563/ICMM/06 ishte për 25 vite, kurse garancioni i dorëzuar për këtë licencë ishte vetëm për 10 vite.

Afati i Licencës për shfrytëzim me nr 665/KPMM/2008 ishte për 22 vite, ndërsa garancioni i dorëzuar ishte vetëm për dy vite.

Afati i Licencës për shfrytëzim me nr. 994/KPMM/2011, ishte për 14 vite, ndërsa periudha e garancionit ishte për katër vite.

Afati i Licencës me nr 1103/KPMM/2011 ishte për 12 vite, ndërsa garancioni vetëm për katër vite.

Rreziku Menaxhimi garancioneve jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore, për pasoje mund të ketë që pas përfundimit të afatit të licencave bartësit e tyre të mos i përgjigjen kërkesave për realizimin e programit rehabilitues të minierave të shfrytëzuara.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për forcimin e kontroleve menaxheriale lidhur me licencat dhe licencat e bartësve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave ligjore ndaj KPMM-së të revokohen.

Çështja 5 - Menaxhimi jo efikas i operimeve ilegale- Prioritet i lartë

- E gjetura** Inspektorët e KPMM-së gjatë vitit kishin identifikuar gjithsej 74 raste të operimeve ilegale. Zyra ligjore kishte shqiptuar gjobën administrative për operuesit ilegal në vlerë prej 592,667€. Më tutje, zyra e prokurimit në muajin nëntor 2014 kishte kontraktuar kompaninë që do të jetë përgjegjëse për transportimin e pasurisë së sekuestruar. Edhe pas kontraktimit të kompanisë sektori i inspektoratit nuk kishte ndërmarre masa për sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve të nxjerra nga operuesit ilegal.
- Rreziku** Mos parandalimi i aktiviteteve apo operimeve ilegale mund të ketë për pasoj përdorimin jo të drejt të vendburimeve/pasurive minerale dhe shkatërrimin e tyre si dhe dështimin për grumbullimin e të hyrave si dhe mbrojtjen e interesave të popullatës vendase.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim sa më të mirë ndërmjet sektorit të inspektoratit, zyrës ligjor, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për administrim dhe sekuestrim të pronës për të pamundësuar ushtrimin e aktiviteteve ilegale.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Shpenzimet totale të KPMM-së përmes procedurave të prokurimit janë në vlerë prej 748,284€. Ne kemi testuar 11 pagesa nga mallrat dhe shërbimet në vlerë prej 42,614€, si dhe 8 pagesa investime kapitale në vlerë prej 387,188€. Po ashtu, për të vlerësuar pajtueshmërinë e procedurave të prokurimit me Ligjin e Prokurimit Publik ne kemi testuar 7 aktivitete të prokurimit në vlerë prej 305,407€. Në përgjithësi në KPMM kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar procesin në tërësi.

Çështja 6 – Dobësi jo sistematike në prokurim- Prioritet i lartë

E gjetura **Furnizim i paplanifikuar dhe jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.** Nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin përfundimtar i cili është dorëzuar në Autoritetin Qendror të Prokurimit (AQP) sipas nenit 8, paragrafi 2 i LPP-së, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të nevojave dhe disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se zyrtari autorizues të autorizojë zyrtarin e prokurimit për inicimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Zyra e prokurimit me datën 31/10/2014 kishte shpallur njoftimin për kontratë dhe kishte arritur marrëveshje me operatorin ekonomik për projektin “Furnizim me një automjete terreni” në vlerë prej 21,890€. Ky aktivitet nuk ishte i përfshirë në tabelat e buxhetit për projekte kapitale për vitin 2014 dhe as në planin përfundimtarë të prokurimit. Më tutje, nuk kishte dërguar në AQP kopjen e deklaratës së nevojave dhe disponueshmerisë së mjeteve.

Vlerësimi i ofertave jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “ArcGIS-Licensë “ ishte përcaktuar kriteri që ofertuesit të ofrojnë një deklaratë (dëshmi) për kërkesat teknike pika 9.2 “Përputhshmëria teknike e ofertës së OE me kërkesat teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit si dhe që OE fitues të ketë dëshmi se nuk është në vonesë në pagesën e energjisë elektrike së paku dy muajt e fundit.

Gjatë testimit tonë kemi vërejtur se KPMM ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik në vlerë prej 32,074€ i cili nuk i kishte plotësuar këto kriteret të përcaktuara në DT. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave e kishin vlerësuar si të përgjegjshëm dhe ishte shpërblyer me kontratë.

Rreziku Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit dhe përzgjedhja e OE pa plotësimin e kriterëve rrit rrezikun e anashkalimit të procedurave ligjore dhe po ashtu rrit edhe rrezikun për menaxhim jo të mirë të parasë publike.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Bordit duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar.

Çështja 7 - Dobësi në procedimin e pagesave për furnizim me karburant - Prioritet i mesëm

E gjetura Në urdhërpagesën në vlerë prej 3,448€ për “Furnizim me karburante për vetura”, kemi vërejtur që KPMM është furnizuar me karburante në muajin maj, pa u siguruar paraprakisht se ishte bërë kërkesa nga sektori përkatës për furnizim dhe pa zotim të mjeteve. Fatura për furnizim me karburant ishte pranuar me datën 12/06/2014, ndërsa zotimi i mjeteve ishte bërë me datën 20/06/2014 dhe urdhërblerja është procesuar me datën 26/06/2014.

Po ashtu, edhe në urdhërpagesën në vlerë prej 3,243€ për “Furnizim me karburante për vetura”, KPMM është furnizuar me karburante për muajin prill para se të bëhet kërkesë nga sektori përkatës për furnizim dhe pa zotim të mjeteve. Fatura për furnizim me karburant ishte pranuar me datën 13/05/2014, ndërsa zotimi i mjeteve ishte bërë me datën 15/05/2014 dhe urdhërblerja është procesuar me datën 28/05/2014

Rreziku Furnizimi me karburant pa inicimin e kërkesave nga sektori përkatës dhe pa zotime të mjeteve mund të sjellë KPMM fillimisht në vështërsi buxhetore si dhe mund të rrit rrezikun për anashkalimin e kontrolleve lidhur me furnizimin me karburant.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Bordit duhet siguroj se është shtuar bashkëpunimi mes sektorëve përkatëse dhe menaxherit të kontratës me qëllim që me kohë të përgatiten kërkesat me shkrim për çdo furnizim me karburant si dhe se zotohen fondet e më pastaj fillon procesi i furnizimit.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Ne kemi testuar pagesa nga avanset për udhëtime zyrtare, pagesat e telefonisë mobile dhe fikse si dhe shpenzimet komunale, ne nuk kemi identifikuar mangësi në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Shpenzimet për paga dhe mëditje paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll). Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit, si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi bërë krahasimin me Payroll. Kemi vërejtur se ka kontrolle adekuate në menaxhimin e dosjeve të personelit.

Megjithatë, në disa aspekte tjera të menaxhimit të burimeve njerëzore kontrollet ishin më pak funksionale. Si rezultat i kësaj, proceset që kishin të bënin me rekrutimin e stafit si dhe me procesin e gradimeve ishin përcjellë me mangësi.

Çështja 8 - Zhvillimi i procedurave të rekrutimit dhe procesi i gradimeve jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore - Prioritet i lartë

E gjetura Mos respektimi i procedurave të rekrutimit. Në dy nga katër proceset e rekrutimit të zhvilluara gjatë 2014, procedurat e rekrutimit nuk ishin zhvilluar konform Ligjit për shërbimin civil, përkatësisht nuk është respektuar kriteri i konkursit publik lidhur me përvojën e punës në njërin rast, si dhe në rastin tjetër kualifikimi përkatës shkollor.

Në pozitën Specialistë i mbështetjes së IT-së është kërkuar dy vite përvojë pune përderisa kandidati i pranuar nuk e kishte dokumentuar përvojën e punës së kërkuar me shpallje publike.

Në pozitën Zyrtare Administrative në Inspektorat është kërkuar diplomë universitare në Fakultetin Juridik, Administratë Publike, ose Ekonomik përderisa kandidatja e pranuar kishte ofruar diplomën universitare nga fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, departamenti Gjeografi drejtim i Përgjithshëm.

Avancimet jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Sipas rregullores nr. 21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civilë neni 4, ceket se "Kërkesa për iniciimin e procedurës për avancim në karrierë bëhet nga udhëheqësi i njësisë dhe dërgohet për aprovim të udhëheqësi më i lartë administrativ" dhe më pas duhet të zhvillohet konkursi i brendshëm me rastin e avancimeve në pozita të caktuara.

Në pesë (5) raste, kërkesat ishin iniciuar nga vet personat që kishin kërkuar avancim në pozitë, të cilat i janë dërguar drejtorit dhe janë aprovuar nga bordi i KPMM-së pa ndonjë procedurë të brendshme të rekrutimit .

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në konkursin publik dhe avancimi i zyrtarëve pa konkurse të brendshme krijon mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve të cilët nuk i kanë shkathtësitë dhe përvojën e duhur profesionale dhe në mungesë të tyre mund të dështojnë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi përkatëse.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se gjatë rekrutimit të stafit respektohen kriteret e konkursit publik me qëllim të përzgjedhjes së kandidatëve me shkathtësi dhe përvojën e duhur profesionale për pozitën e caktuar. Po ashtu, duhet të siguroj që procesi i avancimeve është zhvilluar përmes një procesi konkurues brenda KPMM-së.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

KPMM ka gjithsej pasuri kapitale në vlerë prej rreth 1,889,264€ ndërsa pasuria jo-kapitale arrin vlerën prej 54,971€. Për menaxhimin e pasurisë jo-kapitale nën vlerën 1,000€ nuk është përdorur programi e-pasuria.

Çështja 9 – Mos përdorimi i programit e-pasuria- Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Rregullores për Menaxhimin e Pasurive, çdo Organizatë Buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€. Pastaj, ky regjistër duhet të jetë i harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurive. KPMM nuk kishte funksionalizuar akoma regjistrin E-pasuria. Pasuritë e kësaj kategorie, ishin prezantuar vetëm në bazë të regjistrit të përgjithshëm.
- Rreziku** Në mungesë të regjistrit E-pasuria, informatat e prezantuara nuk do të jenë në përputhje me formatet standarde të kërkuara, andaj të dhënat e prezantuara nuk mund të jenë të besueshme.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ka ngritur çështjen e funksionalizimit të e-pasurisë me Ministrin e Administratës Publike për të siguruar që të gjitha kërkesat për menaxhimin e pasurisë përmbushen në plotësi.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Borgjet totale të kompanive ndaj KPMM-së, në fund të vitit ishin në vlerë prej 15,320,160€. Ky borgj përbëhet prej rentës minerare në vlerë prej 8,562,717€, gjoba administrative 5,271,242€ dhe taksa administrative 698,838€. Borxhet totale të kompanive ndaj KPMM-së, me 31 dhjetor 2013 ishin në vlerë prej 12,858,361€. Krahasuar me 2013, kemi rritje të borxheve në 2014 prej 2,461,799€ apo 19%.

Borxhet e vjetra, të cilat janë rritur prej vitit në vit rrezikohen të bëhen të pa arketushme. Kjo tregon mos efikasitetin e kontrolleve në mbledhjen e borxheve.

Çështja 10 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lart

E gjetura Me qëllim të zvogëlimit të llogarive të arkëtueshme, KPMM në vitin 2014 ka blerë një program apo softwer për kalkulimin e interesit për të aplikuar interesin për të gjitha ato kompani të cilat nuk respektojnë kushtet e marrëveshjes për programim të borgjit. Nga gjithësej 53 marrëveshje për programim të borgjit, 20 raste kompanitë e licencuara nuk iu kanë përmbajtur kushteve të marrëveshjeve. Për këto kompani, KPMM nga tremujori i fundit të vitit 2014, ka aplikuar interesin në mënyrë retroaktive për tërë vitin 2014, prej 2% në muaj për mos shlyerje të borxheve.

Rreziku Rritja e llogarive të arkëtueshme prej vitit në vit është mjaft shqetësuese, mos zbatimi i masave parandaluese rezulton në humbje të drejtpërdrejtë financiare për KPMM-në dhe buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit duke zbatuar masa parandaluese përfshirë edhe revokimin e licencave me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së kompanive në përmbushjen e obligimeve dhe me këtë edhe rritjen e inkasimit të parasë publike.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) në kuadër të KPMM-së përbëhet nga Drejtori. NJAB ka përgatitur planin vjetor për vitin 2014, si dhe planin strategjik për periudhën 2014 - 2016.

NJAB kishte përgatitur planin e auditimit për vitin 2014 duke u bazuar në fushat të cilat paraqesin rrezik më të lartë. Në plan kishte paraparë realizimin e gjashtë (6) auditime që kryesisht mbulonin aktivitetet e vitit aktual. Deri në fazën e finale të auditimit NJAB ka realizuar pesë (5) auditime. Përderisa është realizuar edhe një auditim me kërkesën e menaxhmentit por i cili nuk ka qenë i planifikuar në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2014.

Vlerësimi ynë është se NJAB ka kryer punën konform Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Planit vjetor. Raportet ishin cilësore dhe të dokumentuara me dëshmi adekuate. Këto raporte i kishin ofruar Menaxhmentit pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Meqenëse, cilësia e punës së NJAB-së ishte në nivelin e pranueshëm në jemi mbështetur në punën e NJAB-së për vitin 2014. Raportet e finalizuara të auditimit lidhur me inspektoratin dhe departamentin ligjorë na shërbyen gjatë përgatitjes së planit tonë të auditimit. Kjo na mundësoi nxjerrjen e konkluzioneve të përshtatshme në fushën e të hyrave.

Komitetit i auditimit në KPMM gjatë vitit 2014 kishte mbajtur katër takime. Në këto takime është diskutuar për implementimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të NJAB, si dhe për rekomandimet e dala nga raporti i auditimit të ZAP-it për vitin 2013.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak KPMM 2013

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Adresimi i rekomandimeve nga vitit paraprak	Kryetari i bordit duhet siguroje se qe plani i veprimit të rishikojë sakte afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra		Në proces të adresimit	
3. Buxhetit	Kryetari i bordit duhet të sigurohet se paraprij e përgatitjes së buxhetit të mbështetet në një analizë rigoroze që reflekton të gjitha informata relevante të përfshira nga viti i kaluar		Në përgatitjen e buxhetit për projekte kapitale duhet të punohet edhe me shumë që të sigurohet një proces buxhetor i cili është i mbështetur në nevojat reale dhe përllogaritjen e përafërta e vlerave të parashikuara me ato të realizuara , me tutje në M&Sh dhe komunalit duhet të punohet ende të realizim më të mirë të buxhetit	
4.2 Planifikimi dhe klasifikimi i shpenzimeve	Kryetari i bordit duhet të sigurohet se ka aplikuar kontrolle shtese në mënyrë që pagesat të regjistrohen në kode adekuate ekonomike	PO		
4.3 Të hyrat	Kryetari i bordit duhet të sigurohet vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit me rastin prej aplikimit , dhënies dhe procesit të menaxhimit të licencave			JO

4.3 Mungesa e planit për inspektimi nga sektori i inspektoratit	Kryetari i bordit duhet të sigurohet është formuar komisioni për aprovimin plani për inspektim e aktivitete minerare	PO		
4.4.1. Prokurimi	Kryetari i bordit duhet të sigurohet të iniciojë një rishikim të brendshëm pse kërkesat e prokurimit nuk janë respektuar në të gjitha rastet		Procesi i vlerësimit të ofertave edhe me tutje duhet të zhvillohen në pajtueshmëri me rregullat ivën ligjore	
4.5.1 Menaxhimi i Automjeteve	Kryetari i bordit duhet të shqyrtoje mundësin për tu pajisur të gjitha automjetet me targa zyrtare në pajtim me kërkesat e UA nr 31/2012 për regjistrim të automjeteve	PO		
4.5.1 Menaxhimi i llogarive të arketueshme	Kryetari i bordit duhet të sigurohet vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrolli për menaxhimin e llogarive të arketueshme dhe inkasimin e të hyrave			JO